



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**Legjislatura III**

Komisioni për Mandate, Imunitete  
dhe Rregullore të Punës  
Mbledhja nr. 6  
Prishtinë, me 26 shtator 2008  
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

**P R O C E S V E R B A L**

**nga mbledhja e Komisionit për Mandate, Imunitete  
dhe Rregullore të Punës**

Në mbledhje morën pjesë: Ahmet Isufi, Kolë Berisha, Hydajet Hyseni, Fatmire Berisha,  
Besa Gaxherri, Radmilla Vujoviç dhe Ismet Beqiri.

Munguan: Džezair Murati, Suzan Novoberdaliu, Ramadan Gashi.  
Nga zyra e NDI morën pjesë z. Reshit Gashi dhe Rinor Beka

Nga zyra mbështetëse mori pjesë: Nur Çeku, Antigona Ibraj.

Mbledhjen e kryesoi:  
Ahmet Isufi, Kryetar i Komisionit

Për këtë mbledhje është propozuar ky rend dite:

- 1. Miratimi i rendit të ditës**
- 2. Miratimi i Procesverbalit nga mbledhja e datës 23.09.2008**
- 3. Shqyrtimi i Rregullores së re të Punës së Kuvendit**
- 4. Të ndryshme**

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e mbledhjes dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

### **1. Miratimi i rendit të ditës**

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

### **2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 23.09.2008**

Procesverbali nga mbledhja e datës 23.09.2008, u miratua pa vërejtje.

### **3. Shqyrtimi i Rregullores së re të Punës së Kuvndit**

Në lidhje me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes tha, sot do të diskutojmë vetëm nëse dikush ka vërejtje në draftin që e kemi harmonizuar.

Fillimisht ai parashtrroi disa vërejtje në draftin e rregullores. Ai gjithashtu kërkoi që të rregullohet edhe emërtimi i Komisionit për Mandate Imunitete dhe Rregullore të Punës së Kuvendit.

**Besa Gaxherri**, propozoi që të caktohet me rregullore, që kryesuesi i komisionit për buxhet dhe financa të jetë nga opozita. Ajo tha se duhet të rregullohet edhe çështja e pagesave të nën komisioneve. znj.Besa Gaxherri, gjithashtu propozoi, që të inkorporohet një rregull e re te Këshilli Gjyqësor, në lidhje me mandatin e Gjykatës Kushtetuese, pra të bartet në Rregullore, pika 2 dhe 3 e nenit 114 të Kushtetutës së Kosovës.

**Hydajet Hyseni**, propozoi që në rregullore të ceket edhe një dispozitë, me të cilën duhet të përcaktohet që shprehjet në Rregullore të Kuvendit, të jenë në harmoni me shprehjet parlamentare të botuara më herët nga OSBE-ja.

**Fatmire Berisha**, theksoi se teksti betimit të deputetëve duhet të korrigjohet në aspektin gjuhësor.

### **4. Të ndryshme**

Në këtë pikë nuk pati çështje për diskutim.

Ahmet Isufi  
Kryetar i Komisionit për  
Mandate, Imunitete dhe Rregullore të  
Punës së Kuvendit

Përgatiti:  
Njësia mbështetëse e komisionit